



Republika Kosova
Komuna Drenas/Gillogoc
Kryetari i Komunës



Nr. 01- 079/03-40690 dt.05.08.2022

NJOFTIM

Në mbështetje të paragrafit 7.3 të nenit 8 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës nr.01-464/01-40545, dt. 05.08.2022 njoftohen të gjithë subjektet e interesit se:

1. Për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik realizimit të Planit Zhvillimor Komunal 2020-2028 dhe Hartës Zonale 2022-2030, mbas plotësimit të të gjitha kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, Kryetari i Komunës në zbatim të ligjit të lartëpërmendur, ka marrë Vendimin nr. 01-464/01-40545, dt.05.08.2022 për shqyrtimin e mëtejme të kërkesës për shpronësim.
2. Kryetari i Komunës do të marrë një Vendim Preliminar brenda periudhës prej 30 ditëve kalendarike pas përmbushjes së kushteve të përcaktuara në nenin 9 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, lidhur me organizimin e dëgjimeve publike.
3. Çdo person i interesuar ka të drejtë të paraqesë komentet e tij me shkrim lidhur me shpronësimin e propozuar në Organin Shpronësues, brenda 10 ditëve kalendarike, mbas shpalljes së Vendimit të Kryetarit të Komunës 01-464/01-40545, dt.05.08.2022, për miratimin e kërkesës për shpronësim ditën e publikimit në njërin nga gazetat me tirazh më të madh në Kosovë.
4. Kryetari i Komunës do të mbajë një dëgjim publik lidhur me shpronësimin e kërkuar për realizimin e Planit Zhvillimor Komunal 2020-2028 dhe Hartës Zonale 2022-2030, për banesat/njësit e ndërtesave të cilat do t'i nënshtrohen procesit të shpronësimit.
5. Të gjithë personat që janë zyrtar publik të Komunës në të cilën mbahet dëgjimi publik apo pronar ose zotërues të interesit në pronën e cila gjindet në këtë pjesë ose avokat apo përfaqësues i ligjshëm të këtyre personave, kanë të drejtë të marrin pjesë në dëgjimin publik.
6. Çdo person i interesuar do t'i jepet mundësi e arsyeshme për t'i shprehur mendimet e tij/saj gojarisht lidhur me shpronësimin e kërkuar në përputhje me paragrafët 2, 3, 4 të nenit 9 të

REO

Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Pluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205.

7. Çdo person i interesuar i cili dëshiron të marrë pjesë ose të shprehë mendimet e tij/saj në dëgjimin publik duhet të sjellë me vete prova të arsyeshme (dokumente) të cilat dëshmojnë se ai/ajo është në fakt zyrtar publik, pronar ose zotërues i interesit ose avokat ose përfaqësues i ligjshëm i atij zyrtari publik, Pronari ose Zotëruesi i Interesit.
8. Dëgjimi publik lidhur me shpronësimin e kërkuar, të të drejtave pronësore apo të drejtave tjera në pronat e paluajtshme që ndodhen brenda juridiksionit territorial të komunës së Drenasit, do të mbahet **me datë 16.08.2022 në ora 10:00, në objektin e Komunës së Drenasit – sala e Kuvendit.**
9. Në rast se prona është objekt i kërkesës shpronësohet pas përmbylljes së procedurës së shpronësimit të inicuar në përputhje me atë kërkesë asnjë kompensim nuk do të paguhet për shpenzimet ose vlerën e çfarëdo përmirësimi të bërë në pronë, objekteve të ndërtuara ose të zgjeruara në pronë, ose pemëve apo bimëve të mbjellura në pronë pas datës së përmbushjes së dispozitave përkatëse të paragrafit 8 të nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205. Çdo person i cili pretendon se ka një interes pronësor ose ndonjë interes tjetër të ligjshëm në pronën përkatëse këshillohet ta shqyrtoj Ligjin Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, dhe të kërkojë ndihmë profesionale juridike për kuptimin e të drejtave të tyre sipas ligjit.
10. Çdo person i cili nuk është emëruar në njoftim dhe i cili pretendon se zotëron një interes pronësor ose interes tjetër të ligjshëm në pronat e paluajtshme që janë objekt shpronësimi duhet të dërgoj në organin shpronësues një përshkrim të pretendimit të tij/saj bazën juridike të atij pretendimi si dhe kopjet e certifikuara të çfarëdo dokumenti që ndërlidhen në atë pretendim.



KRYETARI I KOMUNËS

Ramiz Lladrovci